

marshin gati tërë natën. Gjatë zbritjes nga bjeshka e *Pashtrikut/Paštrik*, në mëngjesin e datës **14.12.1998**, nga ora 4:00, në afërsi të postbllokut ushtarak *Liken*, njësi të vëzhgues i kolonës së UÇK-së u ndesh me pjesëtarët e Brigadës së 549 të Motorizuar të UJ-së. Për shkak të mjegullës dhe borës, disa pjesëtarë të grupit e humbën orientimin dhe ranë në fusha të minuara. Po atë ditë, në tri incidente të ndara, vdekjen e gjetën 40 pjesëtarë të UÇK-së, në mesin e tyre edhe një grua, Lulete Shala. Hazir Kryeziu u zhduk. [Gjatë ditës, nga të ftohtët kanë ndërruar jetë tre ushtarë: Selim Selimi, Astrit Bytyqi dhe Besim Qarri]. Pas dite, në ora 17:00, pjesëtarët e UJ-së i kanë zënë peng nëntë ushtarët e UÇK-së. Ushtarët e tjerë, së bashku me të plagosurit, u kthyen në Shqipëri. Rreth orës 13:00, ushtarët serb i transferuan me helikopter trupat e 35 ushtarëve të UÇK-së në morgun e spitalit të Prizrenit/Prizren.

Në datën 19.12.1998, familjarët i kanë marrë trupat nga morgu, falë ndërmjetësimi të Misionit Verifikues Kosovar. I bartën në Krushë të Madhe/Velika Kruša. Një ditë më vonë, që të gjithë të rënë u varrosën në Polac/Poljance [Skënderaj/Srbica], në vendin i cili nga ajo ditë quhet *Kodra e Dëshmorëve/Breg palih boraca*.

Dy trupa të pidentifikuara u varrosën më 22.12.1998 në Kleçkë/Klečka. Trupat e Afrim Musliut, Selim Selimit, Astrit Bytyqit, Veli Ballazhit dhe Besim Qarrit kanë mbetur në bjeshkë deri më 15.06.1999, kur u zbuluan nga pjesëtarët e UÇK-së. U varrosën në *Pashtrik/Paštrik*, por, një muaj më vonë, u riarrosën në varrezat e fshatrave apo qyteteve të tyre të lindjes. Familjarët i kanë riarrosur mbetjet mortore të Veli Ballazhit më 29.08.1999, në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Pustenik.

Pas lufte, më 1.09.1999, familjarët i kanë riarrosur mbetjet mortore të Avni Kutlllovci në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Stanocin e Epërm/Gornje Stanovce, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn.

Në muajin tetor të vitit 1999, patologët i kanë identifikuar dy trupa që ishin varrosur në Kleçkë/Klečka. Ata ishin Gani dhe Ramadan Elshani. Ramadanin e riarrosën në varrezat e njëjta, ndërkaq famil-

jarët e riarrosën Ganiun më 30.10.1999 në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Krajkovë/Krajkovo.

Familjarët janë ende duke kërkuar ndriçimin e fatit dhe gjetjen e trupit të Hazir Kryeziut. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, lënda e tij është sistemuar me numër BLG-804114-01.

Burimet: deklarata S.H, FDH-36497; deklarata A.S, FDH-36455; deklarata S.B, FDH-36454; deklarata R.Q, FDH-36453; deklarata N.K, FDH-36452; deklarata B.K, FDH-36451; deklarata B.B, FDH-36450; deklarata S.H, FDH-36449; deklarata S.H, FDH-36448; deklarata Xh.Q, FDH-36446; deklarata S.H, FDH-36441; deklarata S.H, FDH-36440; deklarata S.H, FDH-36439; deklarata S.H, FDH-36438; deklarata S.H, FDH-36437; deklarata S.H, FDH-36436; deklarata S.H, FDH-36435; deklarata S.H, FDH-36434; deklarata S.H, FDH-36433; deklarata Z.K, FDH-33626; deklarata Y.G, FDH-33022; deklarata S.G, FDH-33021; deklarata H.M, FDH-32794; deklarata M.E, FDH-31963; deklarata A.A, FDH-31864; deklarata L.Xh, FDH-31862; deklarata H.B, FDH-30710; deklarata M.T, FDH-26766; deklarata G.B, FDH-23629; deklarata E.B, FDH-23613; deklarata M.X, FDH-23598; deklarata H.H, FDH-23597; deklarata H.E, FDH-23596; deklarata T.H, FDH-20891; deklarata S.S, FDH-23576; deklarata B.R, FDH-23595; deklarata F.Q, FDH-20889; deklarata H.O, FDH-11601; deklarata G.R, FDH-3569; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XXII, 809; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 385-388; SHF DUÇK, *Feniksët...3*, 123-125, 129-132; SHF DUÇK, *Feniksët...4*, 33-35, 53-57, 269-274; SHF DUÇK, *Feniksët...5*, 177-181; SHF DUÇK, *Feniksët...7*, 169-174; SHF DUÇK, *Feniksët...8*, 253-256; SHF DUÇK, *Feniksët...10*, 253-254; N. Krasniqi, *Kohë...*, 292-293; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; TMK, *Lista...*, FDH-13257; *20 out of 36 Albanians Killed in the Prizren Border Area Identified*, pasqyra e lajmeve, KIC, 18.12.1998, FDH-30852; *Haxhi Rexhememetaj Is Not Among the Killed in the Border Area, His Father Says*, pasqyra e lajmeve, KIC, 19.12.1998, FDH-30853; *They don't need mocking words – their deeds make them immortal*, pasqyra e lajmeve, ARTA, 20.12.1998, FDH-36466; *Albanian Casualties Reported in Unsolved Shooting Incident In Prizren Area Overnight*, pasqyra e lajmeve, KIC, 14.12.1998, FDH-30840; *At Least 31 Albanians Killed by Serb Army on Monday*,